

*Duke Mbështetur Qeverisjen e Mirë dhe Qytetarinë Aktive
Supporting Good Governance and Active Citizenry*

Monitoruesi i Korrupsionit 2011

Raporti Vjetor mbi Monitorimin e Aktiviteteve Institucionale në Luftë
Kundër Korrupsionit

*“... lufta ndaj korrupsionit dhe krimet të organizuar është një
parakusht thelbësor për anëtarësimin e Kosovës në Bashkimin Evropian...”*



British Embassy
Pristina

Publikimi i këtij Raporti u mundësua nga Ambasada Britanike në Kosovë. Qëndrimet në këtë Raport nuk reflektojnë qëndrimet e Ambasadës.

Përmbajtja

Përmbledhje Ekzekutive.....	3
Hyrje.....	5
Qeveria e Kosovës.....	7
Kuvendi i Kosovës.....	9
Sistemi Gjyqësor.....	13
Këshilli Gjyqësor i Kosovës.....	14
Prokuroria e Kosovës.....	14
Policia e Kosovës.....	15
Agjencia Kundër Korrupsion.....	15
Doganat e Kosovës.....	16
Raportet Ndërkombëtare.....	17
Raporti i Progresit.....	17
Transparency International.....	17
Freedom House.....	17
Departamenti i Shtetit.....	18
Raporti i Pulsit Publik.....	18
Raporte nga Shoqëria Civile.....	19
Organizata Çohu.....	19
Instituti Demokratik i Kosovës.....	19
Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillim të Politikave.....	20
Falënderime.....	21
Rreth Lëvizjes FOL.....	22

Lista e Akronimeve/Shkurtesave

AAK - Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës

AKK - Agjencia Kundër Korrupsionit

AKR - Aleanca Kosovare e Re

DHKEK - Drejtoria për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit

DK - Doganat e Kosovës

EULEX - Misioni i Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë

FH - Freedom House

KDI - Kosovo Democratic Institute (Instituti Demokratik i Kosovës)

KGJK - Këshilli Gjyqësor i Kosovës

KKKK - Këshilli Kombëtar Kundër Korrupsionit

KQZ - Komisioni Qendror Zgjedhor

LDK - Lidhja Demokratike e Kosovës

PDK - Partia Demokratike e Kosovës

PK - Policia e Kosovës

RP - Raporti i Progresit

VV - Vetëvendosje

ZPD - Zyra e Prokurorit Disiplinor

TI - Transparency International

Përmbledhje Ekzekutive

Qeveria e Kosovës gjatë vitit 2011 ka miratuar gjithsej 367 vendime. Prej këtyre vendimeve vetëm 10 kanë qenë në fushën e parandalimit dhe luftimit të korrupsionit. Në kuadër të këtyre vendimeve hyjnë miratimi i projektligjeve për Prokurimin Publik, Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik, ai për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, projekt-ligji për mbrojtjen e informatorëve (whistle blowers law), projekt-ligji për mbrojtjen e dëshmitarëve, ai për financimin e subjekteve politike, projekt-ligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për përfitimin e ish zyrtarëve të lartë

Gjithashtu, qeveria e Kosovës ka përkrahur kërkesën e Prokurorisë Speciale të Kosovës për kompensimin e shtesave dhe stimulimin financiar për punonjësit e saj, është emëruar kryeshefi ekzekutiv në Agjencionin për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe është miratuar projekt-kodi Penal i Republikës së Kosovës.

Kuvendi i Kosovës gjatë vitit 2011 ka mbajtur gjithsej 37 seanca. Gjatë kësaj periudhe janë miratuar një sërë ligjesh anti-korrupsion, të cilat pritet të ndikojnë drejtpërdrejt ose tërthorazi në luftimin e korrupsionit, krimet të organizuar dhe ekonomisë joformale. Ligjet e aprovuara gjatë këtij viti janë: Ligji për mbrojtjen e dëshmitarëve, Ligji për mbrojtjen e Informatorëve, Ligji për Deklarimin, Prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë së Zyrtarëve të Lartë Publik, Ligji për parandalimin e konfliktit të interesit, Ligji për prokurimin publik, për financimin e subjekteve politike dhe Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për përfitimin e ish- zyrtarëve të lartë.

Në seancat e mbajtura në këtë interval kohor deputetët më të zëshëm kanë qenë: Visar Ymeri (VV), Ardian Gjini (AAK), ndërkaq më pak të zëshëm: Ukë Rugova- Lista Ibrahim Rugova dhe Azem Sylja (PDK).

Këshilli Gjyqësor ende nuk është kompletuar. Kuvendi pritet t'i emërojë tre anëtarë të Këshillit, duke përfshirë dy gjyqtarë nga komunitetet pakicë. Nga statistikat e këtij institucioni shohim se përgjatë vitit 2011 janë ndërmarrë një sërë vendimesh dhe masash në luftë kundër korrupsionit. Gjatë periudhës raportuese Gjykata e Qarkut ka trashëguar 45 lëndë, 24 lëndë të pranuar dhe 16 lëndë të zgjidhura. Nga 9 lëndë më aktgjykim gjykues, 6 lëndë kanë përfunduar me burg, 3 me dënim me kusht, 1 me dënime të tjera, 2 me aktgjykim lirues dhe 5 lëndë në mënyra të tjera. Në fund të periudhës raportuese kanë mbetur 53 lëndë të pazgjidhura.

Në gjykatat komunale janë 206 lëndë të trashëguara nga periudha raportuese, 132 lëndë janë të pranuar dhe 120 lëndë të zgjidhura. Nga 82 lëndë me aktgjykim gjykues, 14 lëndë kanë përfunduar me dënim me burg, 45 lëndë me dënim me gjobë, 22 lëndë dënim me kusht, 1 lëndë me dënime të tjera. Me aktgjykim lirues janë shqiptuar 6 lëndë, me aktgjykim refuzues 3 dhe 29 në mënyra të tjera. Viti 2011 është përmbyllur me 218 lëndë të pazgjidhura.

Prokuroritë e Republikës së Kosovës gjatë vitit 2011 kanë paraqitur 959 kallëzime penale për korrupsion kundër 1862 personave. Gjatë periudhës janar-dhjetor 2011 prokuroritë e

vendit kanë zgjidhur 538 kallëzime penale kundër 1038 personave, ndërkaq kanë mbetur të pazgjidhura 421 kallëzime penale kundër 824 personave. Nga rastet e zgjidhura, janë ngritur 107 porpozimakuza kundër 139 personave, 107 aktakuza kundër 478 personave, janë hedhur 165 kallëzime penale kundër 216 personave dhe janë pushuar hetimet në 31 raste kundër 71 personave.

Sipas statistikave të Drejtorisë për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsion (DHKEK) rezulton që gjatë viti 2011 janë kryer hetime ndaj 739 personave, 97 janë arrestuar, 319 janë dërguar në Prokurori me kryerës të njohur, 11 raste janë dërguar në prokurori me N/N dhe 192 raste të dërguara me raport të Prokurorit.

Agjencia Kundër Korrupsion ka përmbyllur procesin e deklarimit të pasurisë nga ana e zyrtarëve të lartë publik. Më shumë se 95 për qind e zyrtarëve të lartë publik e kanë deklaruar pasurinë e tyre tek Agjencia Kundër Korrupsionit, ndërkaq 84 zyrtarë nuk e kanë deklaruar pasurinë. Përveç kësaj, 26 zyrtarë të tjerë e kanë deklaruar pasurinë e tyre, por në fakt formulari nuk është plotësuar konform ligjit dhe standardeve e kritereve të përcaktuara nga AKK-ja.

AKK-ja ka ndërmarrë nismën për përpilimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit Kundër Korrupsionit (2012-2016), një dokument shtetëror për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit.

Doganat e Kosovës kanë shqiptuar gjithsej 41 masa disiplinore: 25 vërejtje me shkrim/gojë, 9 raste ndalim promovimi, 1 rekomandim për mosvazhdim të kontratës së punës, 2 raste rekomandimi për trajnim, 3 raste transferimi i detyrueshëm, 1 rast degradim nga pozita, 1 rast anulim performance dhe 1 rast kompensim i pronës së dëmtuar të Doganave. Ndërkaq, në kuadër të Sektorit për Standarde Profesionale Doganat e Kosovës kanë iniciuar gjithsej 21 raste: 3 raste për keqpërdorim të detyrës zyrtare, 2 raste për neglizhencë gjatë kryerjes së detyrës zyrtare, 7 raste për sjellje joprofesionale, 2 raste për mosdeklarim, 4 raste për dëmtim të pronës së Doganës, 1 rast për mosparaqitje në punë, 1 raste për marrje ryshfeti dhe 1 rast për marrje të narkotikëve.

Gjatë vitit 2011 janë publikuar disa Raporte Ndërkombëtare për gjendjen në Kosovë: Raporti i Progresit, Freedom House, Departamenti i Shtetit, Raporti i Pulsit Publik, Transparency International, etj.

Shoqëria civile ka realizuar një sërë aktivitete në luftën e saj kundër korrupsionit; ka publikuar disa raporte të rëndësishme mbi korrupsionin dhe ka mbajtur tryeza të ndryshme diskutimi mbi gjendjen e sundimit të ligjit në Kosovë.

Hyrje

Kosova si një prej vendeve më të prekura nga korrupsioni më 2001 është përballur me mungesë të gatishmërisë në luftë kundër korrupsionit. Veprimet e ndërmarra në fushën kundër korrupsionit, si ai për themelimin e mekanizmave institucional dhe aprovimin e ligjeve kundër-korrupsion mund të shihen si dështim, ndonëse është herët të flitet për efektin e tyre konkret. E njëjta gjë vlen edhe në aspektin e ndjekjes apo gjyqimit të rasteve korruptive. Ndonëse ka raste të korrupsionit, ato nuk e kanë një trajtim të mirëfilltë nga sistemi i drejtësisë në Kosovë. Nga të gjeturat tona rezulton se përgjatë vitit 2011 kanë ndodhur tri zhvillime esenciale në fushën kundër korrupsionit, por që efektet e tyre në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit nuk mund të maten brenda afatit të këtij raporti.

Së pari, institucionet e Kosovës kanë aprovuar dy ligje antikorrupsion: atë për Deklarimin e Pasurisë dhe atë të Parandalimit të Konfliktit të Interesit. Megjithëse aprovimi i këtyre dy ligjeve shënon një avancim cilësor në kodifikimin ligjor të luftës kundër korrupsion, prapë se prapë paketa ligjore kundër korrupsion mbetet e mangët. Kjo bën që kodifikimi juridik i luftës kundër korrupsion të jetë larg nevojave reale që ka Kosova. Së dyti, Agjencia Kundër Korrupsion gjatë vitin 2011 ka marrë iniciativë për përpilimin e dokumentit strategjike kundër korrupsion, siç është Strategjia dhe Plani i Veprimit Kundër Korrupsionit (2012 - 2016). Iniciativa për përpilimin e dokumenteve strategjike kundër korrupsion ndërmerret nga AKK-ja, me gjithë faktin që ky institucion nuk kishte

bërë paraprakisht një studim mbi efektet reale të Strategjisë dhe Planit të Veprimit kundër Korrupsionit 2009-2011.¹ AKK-ja, vetëm pas shprehjes së pakënaqësisë së disa organizatave të shoqërisë cilave, ka ndërmarrë një nismë për analizmin e dokumentit strategjik antikorrupsion të periudhës 2009-2011.

Po ashtu, AKK-ja ka filluar procesin e përpilimit të këtyre dokumenteve strategjike pa një hulumtim paraprak empirik mbi korrupsionin si dhe pa një analizë të detajuar të të metave dhe dobësive të kuadrit ligjorë dhe institucional antikorrupsion. Sidoqoftë, efektet reale të këtyre dokumenteve strategjike kundër korrupsion mbeten të shihen në vitet në vijim.

Aspekt tjetër që e ka karakterizuar vitin 2011 ka qenë edhe iniciativa e presidentes së vendit për themelimin e Këshillit Kombëtar Kundër Korrupsion (KKKK), një forum koordinues i institucioneve në luftë kundër korrupsionit në Kosovë. Këshilli i themeluar me iniciativë të Presidentes vjen në një kohë kur Kosova po përballlet me vështirësi të pakapërcyeshme në konsolidimin e brendshëm të sundimit të ligjit dhe të ndërtimit të institucioneve demokratike. Po kjo iniciativë e Presidentes vjen në një kohë kur vendi ka pengesa serioze edhe në aspektin e përfaqësimit ndërkombëtar, veçanërisht atë Evropian, dhe atë jo vetëm për shkak të mos njohjes së shtetësisë së shpallur nga pesë vende anëtare të Bashkimit Evropian, por edhe për shkak të

¹ Lëvizja FOL, Hulumtim Politikash: Dobësitë e Strategjisë Kundër Korrupsion dhe Planit të Veprimit 2009-2011, nentor 2011

leadershipit të lartë politik i cili akuzohet për përfshirje të drejtpërdrejt në krim të organizuar dhe korrupsion.

Në këtë kontekst, duke parë me shqetësim të madh këtë fenomen, Lëvizja FOL, me përkrahjen e Ambasadës Britaneze në Prishtinë, ka realizuar projektin e saj “Monitoruesi i Korrupsionit” që nga Marsi i vitit 2011. Përmes këtij projekti FOL është munduar të nxjerrë në shesh (mos)punën e institucioneve karshi korrupsionit, duke ndikuar që kjo luftë të jetë në kryeagjendën e të gjitha institucioneve të Republikës së Kosovës”.

FOL-i konsideron se lufta ndaj korrupsionit duhet të kalojë nga sfera e retorikës në atë të veprimeve konkrete, qasjes serioze dhe rezultateve të prekshme. Kjo është rruga e vetme që Kosova ta përmirësojë legjitimitetin e saj të brendshëm dhe ndërkombëtar. Ta etablojë demokracinë, shtetin e së drejtës dhe të jetë e krahasueshme me shtetet perëndimore dhe shoqëritë e lira.

KOHA është TANI!

Qeveria e Kosovës


Niveli i korrupsionit vazhdon të jetë një ndër shqetësimet kryesore në vendin tonë. Raporti i Transparency International rreth Indeksit të Perceptimit të Korrupsionit për vitin 2011 e rendit Kosovën si vendin më të korrumpuar në rajon, respektivisht e 112-a në nivel global.² Qeveria duhet ta vendos si prioritet luftimin e korrupsionit. “Prezenca kaq e madhe e korrupsionit tregon për një dështim të Qeverisë”, kështu është shprehur në një intervistë për gazetën “Koha Ditore”, zëvendës drejtori ekzekutiv i Transparency International, z. Miklos Marschall.³

Poashtu, sipas një hulumtimi të kryer me qytetarët e Kosovës nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara del se korrupsioni është ndër shqetësimet kryesore të qytetarëve.⁴ Edhe Raporti i Progresit për vitin 2011 ndër sfidat kryesore për Kosovën e rendit krimin e organizuar dhe korrupsionin. Po sipas këtij raporti shumë pak është punuar në luftimin e këtyre dukurive negative.⁵

Nga ana tjetër retorika e Qeverisë së Kosovës, respektivisht e kryeministrit Hashim Thaçi vazhdon, ndërkohë që rezultatet e prekshme në luftën

antikorrupsion mungojnë. Shefi i ekzekutivit kosovar dhe bartësit e tjerë institucionalë kanë premtuar luftë të “ashpër” dhe të “pamëshirshme” ndaj praktikave korruptive.

Megjithatë, gjatë monitorimit të punës së Qeverisë për vitin 2011 Lëvizja FOL ka vërejtur një progres të kufizuar në luftimin e korrupsionit. Nga ky monitorim ka rezultuar se lufta e qeverisë më shumë është fokusuar në sferën e retorikës e më pak në atë të veprimeve konkrete dhe rezultateve të prekshme. Gjatë vitit 2011, janë miratuar 367 vendime. Prej tyre, 11 kundër korrupsionit, ndërkaq 356 për çështje të tjera.



Nëse i analizojmë vendimet e tilla në mënyrë kronologjike, shohim se gjatë dy muajve të parë të vitit 2011, janar-shkurt, janë miratuar 3 vendime, nga të cilat asnjëri në fushën kundërkorrupsion. Në dy muajt tjerë, mars-prill, qeveria ka miratuar gjithsej 50 vendime, njëri nga të cilët në sferën antikorrupsion: vendimi për Strategjinë Legjislative për vitin 2011. Në kuadër të kësaj strategjie hyjnë: projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë

²Transparency International, nentor 2011; http://www.transparency.org/publications/publications/other/corruption_perceptions_index_2011

³Korrupsioni në Kosovë është pjesë e sistemit; Koha Ditore; 10.12.2011 <http://www.kohaditore.com/?page=1,10,80208>

⁴Ekonomia, varfëria dhe korrupsioni, problemet kryesore në Kosovë; Zëri i Amerikës; 06.07.2011 <http://www.voanews.com/albanian/news/Ekonomi-varferi-korrupsion-probleme-Kosove-2011-07-06-125082699.html>

⁵Publikohet raporti i progresit për Kosovën; Alb Info; 12.10.2011 <http://www.albinfo.ch/ch-ballkani/aktuale/publikohet-raporti-i-progresit-p%C3%ABr-kosov%C3%ABn-41254>

Publik, ai për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, projekt-ligji për mbrojtjen e raportuesve (ëhistle bloëers laë), projektligji për Parandalimin dhe Luftimin e Krimin të Organizuar, projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit mbi Prokurimin Publik dhe ai për Financimin e Subjekteve Politike. Ndryshimi i ligjeve ekzistuese dhe miratimi i projektligjeve të tjera përbëjnë hapin më të rëndësishëm për kompletimin e paketës anti-korrupsion, e cila më pastaj do t'i reduktojë ndjeshëm hapësirat ligjore që ekzistojnë në ligjet ekzistuese për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit. Gjatë muajit maj të këtij viti janë miratuar gjithsej 27 vendime, njëri prej tyre në sferën kundër korrupsionit. Me këtë vendim Qeveria ka përkrahur kërkesën e Prokurorisë Speciale të Kosovës për kompensimin e shtesave dhe stimulimin financiar për punonjësit e saj.⁶ Në muajin qershor janë marrë gjithsej 58 vendime, njëri nga të cilët bën pjesë në kuadër të kompletimit të legjislacionit kundër korrupsionit. Me këtë vendim Qeveria ka miratuar projektligjin (me vërejtje) për Prokurimin Publik. Ndryshimi i këtij ligji ka ardhur pas rekomandimeve të dhëna nga Raporti i Progresit i Komisionit Evropian dhe nga ana e shoqërisë civile. Në amandamentin 5 të këtij projektligji, i është dhënë përgjegjësi zyrtarëve të lartë shtetëror, presidentit, kryeministrit, kryeparlamentarit, ministrave dhe kryetarëve të komunave për të nënshkruar çdo kontratë të prokurimit publik që kalon vlerën mbi 10 mijë euro. Qeveria e Kosovës gjatë muajve korrik-gusht ka miratuar gjithsej 88 vendime, 51

në korrik, 37 gjatë gushtit. Derisa në muajin korrik janë nxjerrë vetëm 3 vendime kundër korrupsion, muaji gusht ka qenë edhe më keq: me vetëm 1 vendim. Në kuadër të këtyre vendimeve hyjnë miratimi i projekt-ligjit për Parandalim të Konfliktit të Interesit, ai për Deklarimin, Kontrollin dhe Prejardhjen e Pasurisë së Zyrtarëve të Lartë Publikë, ai për Mbrojtjen e Informatorëve, si dhe ai për Financimin e Subjekteve Politike. Ndryshimi i këtyre ligjeve ka qenë rezultat i zbrazëtirave të shumta ligjore - të cilat janë evidentuar nga shoqëria civile, Agjencia Kundër Korrupsionit dhe mekanizmat e shumtë ndërkombëtarë. Megjithatë, ndryshimet e bëra nuk janë ende në përputhje me rregullat, standardet dhe praktikën ndërkombëtare. Madje, sipas strategjisë legjislative të Qeverisë projekt-ligjet e tilla është dashur të procedohen me herët në Kuvendin e Kosovës. Nëse i analizojmë afatet kohore të kësaj strategjie vërejmë se projektligji për Deklarimin, Kontrollin dhe Prejardhjen e Pasurisë është dashur të miratohet në muajin maj, ndërkaq Qeveria e ka miratuar atë në muajin korrik. Po ashtu, projektligji për Parandalim të Konfliktit të Interesit është dashur të miratohet në muajin maj, por kjo gjë ka ndodhur në muajin korrik. Kurse projektligji për Mbrojtjen e Informatorëve, i cili është dashur të miratohet qysh në muajin mars, është miratuar tek në fund të muajit korrik.

Nga ana tjetër, projektligji për Financimin e Subjekteve Politike është miratuar sipas kërkesave kohore të strategjisë, ai prapëseprapë nuk është në përputhje me praktikën ndërkombëtare, duke u lënë hapësirë bizneseve dhe

⁶ Me gjerësisht shih vendimin e Qeverisë, nr. 05/14, 4 maj, 2011, fq. 1

partive politike të implikohen në afëra të mundshme korruptive.

Gjatë muajve shtator - tetor, Qeveria e Kosovës ka miratuar 61 vendime, nga të cilat 25 në shtator, 36 gjatë tetorit. Vetëm 3 prej tyre kanë qenë në dobi të luftës së korrupsionit. Në muajin shtator, respektivisht me 28 shtator 2011, Qeveria e Kosovës morri vendim që Z. Rrahim Rama të emërohet Kryeshef Ekzekutiv në Agjencioni për administrimin e pasurisë së sekuestruar.⁷ Në Mbledhjen e Qeverisë të mbajtur më 10 tetor 2011 u mor vendim për miratimin e Projektkodit Penal të Republikës së Kosovës, i cili është përgatitur dhe sponsorisuar nga Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me përfaqësuesit e Institucioneve vendore e ndërkombëtare. Miratimi i këtij Projektkodi paraqet njërin ndër angazhimet direkte të Ministrisë së Drejtësisë, për plotësimin e infrastrukturës ligjore në fushën e drejtësisë penale si dhe eliminimit të zbrastësive dhe mangësive ligjore në këtë fushë. Vendim i fundit i Qeverisë së Kosovës lidhur me fushën kundër korrupsionit për periudhën shtator-tetor 2011 është vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Strategjisë Legjislative të vitit 2011 të Qeverisë së Kosovës. Me këtë vendim Qeveria e Kosovës ka vendosur që Projektligji për konfiskimin e pasurisë të jetë pjesë e Strategjisë Legjislative të vitit 2011, e me të cilin vendim do të mund të kompletohet paketa ligjore kundër korrupsionit.

Nëntori e dhjetori 2011 kanë qenë muajt më pasivë në luftën kundër korrupsionit nga ana e Qeverisë. Nga 80 vendime të

miratuara nga kjo qeveri asnjë nuk ka qenë në fushën antikorrupsionit apo të krimit të organizuar.

Kuvendi i Kosovës

Kuvendi i Kosovës përgjatë vitit 2011 ka mbajtur gjithsej 37 seanca plenare.⁸ Gjatë këtyre seancave janë miratuar një sërë ligjesh, të cilat do të mund të që do të ndikojnë drejtpërdrejt ose tërthorazi në luftimin e korrupsionit, krimit të organizuar dhe ekonomisë joformale.

Ligjet e aprovuara:

- Ligji për mbrojtjen e dëshmitarëve;⁹
- Ligji për mbrojtjen e Inormatorëve;¹⁰
- Ligji për Deklarimin, Prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë së Zyrtarëve të Lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë;¹¹
- Ligji për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik;¹²
- Ligji për prokurim publik në Republikën e Kosovës;¹³
- Ligji për financimin e subjekteve politike¹⁴

⁸ Një seancë solemne, 4 seanca të jashtëzakonshme, 1 mbledhje komemorative dhe 1 seancë konsultive e Legjislaturës së IV

⁹ Nr.04/L-015,29 korrik 2011, dekreti nr. DL-020-2011, i shpallur me 12.08.2011

¹⁰ Nr. 04/L-043, 31 gusht 2011, dekreti nr. DL-031-2011, i shpallur me 31.08.2011

¹¹ Nr. 04/L-05, 31 gusht 2011, dekreti nr. DL-028-2011, i shpallur me 31.08.2011


¹² Nr. 04/L-051, 31 gusht 2011, dekreti nr. DL-029-2011, shpallur me 31.08.2011

¹³ Nr. 04/L-042, 29 gusht 2011, dekreti nr. DL-032-2011, i shpallur me 31.08.2011

⁷ Qeveria e Kosovës, vendimi Nr.03/39 (28.09.2011)

- Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për përfitimin e ish zyrtarëve të lartë;¹⁵

Pritet që këto ligje në mënyrë direkte apo indirekte të kontibojnë sadopak në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit. Ligjet të cilat janë paraparë me Strategjinë Legjislative të Qeverisë për vitin 2011¹⁶ të fushës antikorrupsion siç janë: Ligji për Konfiskimin e pasurisë së paligjshme; Ligji Anti-Mafia; Ligji për parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar; si dhe ndryshim/plotësimi i ligjit për Financimin e Subjekteve Politike nuk janë miratuar në afatin e paraparë nga Qeveria, ndaj mbetet të miratohen muajt në vazhdim të këtij viti.



Lëvizja FOL edhe gjatë vitit 2011 e ka përcjellur punën e Kuvendit të Kosovës për të cilën ka raportuar çdo dy muaj. Kuvendi i Kosovës mbledhjen e parë e ka mbajtur gjatë muajit shkurt, gjatë seancës së parë është bërë betimi i

¹⁴ Ligji është miratuar në Kuvend me 21.12.2011, kurse është shpallur me Dekretin e Presidentit të Republikës së Kosovës nr.DL-055-2011, Datë 30.12.2011

¹⁵ Nr. 04/L-038, 1 nëntor 2011, dekreti nr. DL-041-2011, i shpallur me 1.11.2011

¹⁶[http://ëëë.kryeministriks.net/repository/docs/Strategjia Legjislative 2011-finale e miratuar me 16 mars 2011 .pdf](http://ëëë.kryeministriks.net/repository/docs/Strategjia%20Legjislative%202011-finale_e_miratuar_me_16_mars_2011_.pdf)

deputetëve dhe është zgjedhur kryetari e nënkryetarët e Kuvendit, në seancën e dytë është zgjedhur Presidenti dhe Qeveria e Republikës së Kosovës. Deputetët e opozitës (LDK, Vetëvendosje dhe AAK) e kanë braktisur seancën e dytë, ndërkaq partitë e tjera (PDK, Koalicioni për Kosovë të Re dhe partitë minoritare) kanë qëndruar në sallë. Procesi i zgjedhjes së presidentit është shoqëruar me parregullsi dhe kundërthënie të shumta.

Në rundin e parë, presidenti arriti t'i marrë vetëm 54 vota, për të dytën herë mori 58, ndaj seanca u ndërpre, Kjo pauzë u cilësua si antikushtetuese dhe në kundërshtim me Rregulloren e punës të Kuvendit. Në rundin , e tretë, me 62 vota është zgjedhur president i tretë i shtetit të Kosovës.¹⁷ Në këtë seancë është votuar edhe Qeveria e Kosovës me 65 vota pro, 1 kundër dhe pa abstenime.¹⁸ Kuvendi i Kosovës gjatë muajit mars i ka mbajtur 4 seanca. Në seancën e parë është miratuar vendimi i Qeverisë lidhur me zgjatjen e ndarjeve buxhetore për muajin mars 2011. Në seancën e dytë është diskutuar për bisedimet ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit. Në seancën e tretë është miratuar rezoluta që autorizon Qeverinë e Kosovës për bisedime me Serbinë. Në këtë seancë është aprovuar edhe formimi i komisioneve parlamentare: 4 komisione të përhershme dhe 9 funksionale. Ndërkaq në seancën e fundit për muajin mars janë miratuar projektligji për buxhetin e Kosovës dhe komisioni për

¹⁷ Fjala është për ish Presidentin, Behxhet Pacolli

¹⁸Lëvizja FOL; Raporti pesë-mujor i Aktiviteteve Institucionale në Luftë kundër Korrupsionit; Maj 2011 <http://levizjafol.org/al/publikimet>

regjistrimin e popullsisë, banesave dhe ekonomive familjare. Në muajin prill, Kuvendi i Kosovës ka mbajtur 3 seanca, dy plenare dhe një seancë e jashtëzakonshme. Në seancën e parë të muajit prill është bërë zgjedhja e presidentes, me 80 vota pro Atifete Jahjaga është presidentja e parë femër në Kosovë.

Në atë të dytën është diskutuar mbi nevojën e themelimit të një komisioni parlamentar mbi hetimin e veprimtarisë së SHIK-ut, duke përfshirë bazën legale të funksionimit të tij, mjetet e financimit, mekanizmat, përgjegjësitë, etj. Në këtë seancë është aprovuar themelimi i Komisionit për amendamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Komisioni për amendamentimin e Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme të Republikës së Kosovës. Po ashtu, gjatë kësaj seance Gani Gërguri është zgjedhur guvernatori i ri i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK). Ndërkaq në seancën e fundit të këtij muaji janë miratuar një sërë ligjesh tregtare dhe është miratuar një rezolutë për të shprehur qëndrimin afirmativ të Kosovës për integrimin e saj në Bashkimin Evropian.

Ndërkaq, në seancat plenare të muajit maj janë shqyrtuar një sërë projektligjesh, por asnjëri prej tyre nuk ka qenë në kuadër të sferës antikorrupsion. Kuvendi i Kosovës gjatë muajit qershor ka mbajtur 4 seanca plenare. Në seancën e parë të muajit qershor janë miratuar disa projekt-ligje në parim dhe është shqyrtuar raporti mbi funksionimin e sistemit të auditimit të brendshëm në sektorin publik të Kosovës për vitin 2010. Në kuadër të seancës së dytë është diskutuar më shumë për Kornizën

Afatmesme të Shpenzimeve (2012-2015). I vetmi deputet që ka ngritur shqetësime rreth nivelit të lartë të korrupsionit ka qenë Haki Demolli nga ana e Lidhjes Demokratike të Kosovës. Në këtë seancë ai ka adresuar të gjeturat e raportit të Lëvizjes FOL mbi “deklarimin e pasurisë së deputetëve në AKK dhe KQZ”, i cili ka evidentuar shpërputhje të madhe ndërmjet deklarimeve në Agjencinë Kundër Korrupsion dhe Komisionit Qendror Zgjedhor. Në këtë seancë janë miratuar disa projektligje e raporte dhe janë zgjedhur disa anëtarë të autoriteteve dhe agjencive kosovare. Në seancën e tretë është organizuar mbledhje komemorative me rastin e vdekjes së deputetes Nekibe Kelmendi (LDK).¹⁹ Ndërkaq, në seancën e fundit për muajin qershor janë miratuar projektligjet të cilat kanë qenë të miratuara në parim.

Kuvendi i Kosovës gjatë muajve korrik-gusht ka mbajtur gjithsej 8 seanca plenare: 2 seanca të jashtëzakonshme dhe 6 të rregullta. Prej tyre 7 janë mbajtur në muajin korrik dhe vetëm 1 në muajin gusht. Në seancat plenare të muajit korrik janë shqyrtuar projektligjet për:

- Mbrojtjen e Informatorëve;
- Prokurimin Publik;
- Deklarimin, Kontrollin dhe Prejardhjen e Pasurisë së Zyrtarëve të Lartë Publik;
- Parandalimin e Konfliktit të Interesit;

Këto ligje janë të domosdoshme për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit në vend.

¹⁹ Transkripti i mbledhjes plenare të Kuvendit, 20 qershor 2011

Në seancën e korrikut është shqyrtuar në lexim të parë projekt-ligji për mbrojtjen e informatorëve, i cili parasheh se zyrtarët që raportojnë për afera të ndryshme korruptive nuk do të ndëshkohen nga eprorët e tyre që janë në pozita më të larta publiko-politike. Sipas zv. kryeministrit Kuçi ky projektligj “do të ketë rol preventiv dhe mënjanues ndaj korrupsionit”. Ndërkaq, partia e dytë në Kuvend LDK-ja, ka dhënë vërejtjet dhe rekomandimet e saj. Sipas deputetit të kësaj partie, Haki Demolli, vetë emërtimi dhe përmbajtja janë të gabuara. Më tutje ai ka argumentuar se në “asnjë dispozitë të këtij projekt-ligji nuk rregullohen kushtet për mbrojtje, procedurat dhe mjetet, masat dhe ndëshkimet eventuale për institucionet që nuk ofrojnë mbrojtje për raportuesit e aferave korruptive”.²⁰ Megjithatë, në shqyrtimin e dytë deputeti i PDK-së, Nait Hasani, ka pohuar se i “tërë ligji është i papajtueshëm”, duke nxjerrë në pah ngjashmëritë ndërmjet spiunit dhe informatorit. Ndërkaq, deputeti nga radhët e AAK-së, Ardian Gjini, ka pohuar se ky projektligj “ka të bëjë me sundimin e ligjit dhe jo me spiunllëkun”. Me 54 vota pro, 2 kundër dhe 2 abstenime Kuvendi ka miratuar projektligjin për Mbrojtjen e Dëshmitarëve.

Në seancën e 28 korrikut është shqyrtuar edhe projektligji për Prokurimin Publik. Me këtë projektligj sigurohet integriteti dhe përgjegjësia e zyrtarëve të lartë publikë, nëpunësve civilë dhe personave të tjerë që janë të përfshirë në aktivitete prokurimi. Po ashtu, përveç nënshkrimit

të zyrtarit përgjegjës për prokurim publik kontratat me vlerë të mesme dhe të mëdha do të nënshkruhen edhe nga ministrat gjegjës. Një rekomandim të tillë e ka dhënë në vazhdimësi Komisioni Evropian, por edhe shoqëria civile - në mënyrë që të ndikohet në ngritjen e transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve publike në fushën e prokurimit publik. Mirëpo, Lidhja Demokratike e Kosovës ka evidentuar dobësi të shumta të këtij projektligji, duke filluar nga mundësia që kanë në dispozicion (krye)ministri që t’i mbajnë të fshehura çmimet e kontratave të nënshkruara, çështja e afateve të kontratave, mundësitë që ministrat kanë për t’i manipuluar tenderët, etj. Megjithatë, pavarësisht vërejtjeve të bëra nga ana e disa deputetëve Kuvendi ka miratuar në parim këtë projektligj.

Po ashtu, Kuvendi e ka shqyrtuar edhe projekt-ligjin tjetër për Deklarimin, Kontrollin dhe Prejardhjen e Pasurisë së Zyrtarëve të Lartë Publikë. Derisa grupi parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka përkrahur në tërësi, deputetët e partive opozitare (LDK, VV dhe AAK) kanë ngritur vërejtje dhe rekomandime të shumta. Gjatë kësaj seance plenare është shqyrtuar edhe projekt-ligji tjetër për Parandalimin e Konfliktit të Interesit. Ky projekt-ligj përcakton rregullat e detyrueshme për zyrtarët e lartë publikë, të cilët gjatë ushtrimit të funksionit publik të parandalojnë konfliktin e mundshëm të interesit ndërmjet interesit publik dhe atij privat.

Gjatë periudhës shtator-tetor, Kuvendi I Kosovës mbajti gjithsej 5 seanca plenare, nga të cilat vetëm 1 gjatë shtatorit e 4 të tjera në tetor. Sa i përket fushës së

²⁰ Kuvendi i Kosovës; Transkripti i mbledhjes plenare të Kuvendit; 28.07.2011; http://ëëë.assembly-kva.org/common/docs/proc/trans_s_2011_07_28_10_al.p df

kundërkorrupsion është folur vetëm në seancën e shtatorit. Në Kuvend me 22 shtator 2011, u shqyrtua rekomandimi i Komisionit për Legjislacion lidhur me zgjedhjen e drejtorit të Agjencisë Kundër Korrupsion. Drejtuesi i këtij komisioni Arben Gashi prezantoi para Kuvendit dy kandidatët për drejtor të agjencisë, të cilët sipas tij i plotësojnë të gjitha kriteret formale-juridike të parapara me Ligjin për Agjencinë kundër Korrupsion²¹. Pjesëmarrës atë ditë në Kuvend ishin 94 deputet, nga të cilët 30 votuan për Bashkim Zeqirin, ndërkaq 54 votuan për Hasan Preteni, 10 vota ishin të pavlefshme. Kryetari i Kuvendit konstatoi se Hasan Preteni do të jetë drejtor i Agjencisë kundër Korrupsion për 5 vitet e ardhshme.²²

Në muajin nëntor, Kuvendi i Kosovës i mbajti 4 seanca plenare. Në seancën e 8 nëntorit grupi parlamentar i LDKsë kërkoi nga Kuvendi që të diskutohet për Raportin e Progresit për Kosovën.

Në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës, më 11 nëntor në pikën e 11 të rendit të ditës u shqyrtua Raporti vjetor i auditimit nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, për vitin 2010, i cili raport pas disa opinionëve, vërejtjeve dhe sygjërimeve u hodh në votim për miratim. Me 64 vota për, 3 kundër dhe asnjë abstenim, u miratua Raporti vjetor i auditimit.

²¹ Ligji për Agjencinë kundër Korrupsion; Ligjin Nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit

²² Ligji për Agjencinë kundër Korrupsion, neni 8, paragrafi 6 ; Drejtori zgjidhet për mandat pesë (5) vjeçar dhe mund të rizgjedhet vetëm edhe për një mandat tjetër.

²³ Ligji për Agjencinë kundër Korrupsion, neni 8, paragrafi 6 ; Drejtori zgjidhet për mandat pesë (5) vjeçar dhe mund të rizgjedhet vetëm edhe për një mandat tjetër.

Gjatë muajit dhjetor u mbajtën 3 seanca plenare dhe një solemne. Në seancën e 8 dhjetorit, deputetëve të Kosovës iu adresua presidentja e Republikës, znj. Atifete Jahjaga²³. Gjatë seancës së fundit për vitin 2011, u shqyrtuan 3 çështje të lidhura me fushën antikorrupsion. U shqyrtua për të dytën herë Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për financimin e subjekteve politike²⁴, Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për administrimin e pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar²⁵ si dhe Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi për emërimin e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Sipas një raporti të cilin e nxjerr çdo 6 muaj Insituti Demokratik i Kosovës²⁶ deputetët më aktiv për 6 mujorin e parë të vitit 2011 (janar-qershor) janë Visar Ymeri nga radhët e VV si dhe Ardian Gjini nga AAK, ndërkaq ata më pasivët janë Azem Sylja nga Partia Demokratike e Kosovës dhe Ukë Rugova nga Lista Rugova. Po duke iu referuar Institutit Demokratik të Kosovës dhe raportit të tyre për Kuvendin e Kosovës për periudhën korrik-dhjetor, deputeti më aktiv është treguar Sabri Hamiti nga radhët e LDK-së derisa më pasivi mbetet Azem Sylja nga PDK-ja.

²³ Kushtetuta e Kosovës, neni 84, pika 30 ; Presidenti i Republikës së Kosovës, së paku një herë në vit i drejtohet Kuvendit të Republikës së Kosovës me një fjalim vjetor.

²⁴ Ligj me ndryshimet e propozuara u miratua me 73 vota pro, 0 kundër, 2 abstenim

²⁵ Miratohet raporti i Komisionit për Legjislacion, lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për administrimin e pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar, me vërejtjet e deputetëve gjatë diskutimit në mbledhje plenare

²⁶ Institutit Demokratik i Kosovës; Fletënotimet; Gusht 2011; <http://www.kdi-kosova.org/publications/FletnotimiCL012011.pdf>

Sistemi Gjyqësor

Njëri ndër pushtetet më të rëndësishme në kuadër të cilitdo sistem politik është pushteti (sistemi) gjyqësor. Ky pushtet, nëse është i paanshëm dhe i pavarur, apriori parandalon dhe kufizon çdo lloj mundësie për shpërdorim të parasë publike apo keqpërdorim të pozitës zyrtare.

Në përgjithësi, Kosova ka përparuar sa i përket sistemit gjyqësor në krahasim me vitin paraprak. Një gjë të tillë e thotë Raporti i Progresit për Kosovën për vitin 2011, i cili më tej shton se Autoritetet e Kosovës kanë vazhduar të zbatojnë legjislacionin e miratuar për reformimin e gjyqësorit, sidomos ligjin për Këshillin Gjyqësor dhe atë për Këshillin Prokurorial, për gjykatat dhe prokurorinë. Buxheti vjetor për gjyqësorin është rritur për rreth 3 milionë euro për këtë vit. Pagat për gjyqtarë dhe prokurorë janë rritur duke përforcuar kështu më shumë pavarësinë e gjyqtarëve. Gjykata Kushtetuese ka marrë një numër vendimesh, të cilat kanë pasur ndikim të konsiderueshëm. Ligji mbi përgjegjësinë penale të personave juridikë për veprat penale, ligji për ndihmën juridike ndërkombëtare në çështje penale, ekstradimit dhe transferimit të personave të dënuar, si dhe ligji për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, janë miratuar në fund të gushtit. Me qëllim të zbatimit të ligjit për ndërmjetësimin, komisioni i ndërmjetësimit ka certifikuar 74 ndërmjetës, prej të cilëve 50 i janë parashtruar Ministrisë së Drejtësisë për të marrë licencën. Po sipas këtij raporti Departamenti përgjegjës për ndihmën juridike ndërkombëtare brenda Ministrisë

së Drejtësisë ka vazhduar të ushtrojë detyrat e tij në mënyrë profesionale dhe efikase. Ligji mbi Këshillin Prokurorial të Kosovës ka hyrë në fuqi më 1 janar 2011. Të nëntë anëtarët e Këshillit Prokurorial janë emëruar, ky këshill ka marrë disa përgjegjësi nga Ministria e Drejtësisë dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës, dhe ka funksionalizuar dy trupa kryesorë: komisionin disiplinor si dhe kolegjin për rekrutimin e prokurorëve të rinj, për të plotësuar 45 pozita të lira.²⁷

Megjithatë sistemi gjyqësor mbetet njëri ndër sistemet më të kritikuar dhe më i ndikuari politikisht. Janë 224 mijë lëndë të pazgjidhura dhe ky numër sa vjen e shtohet.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës


Gjyqësori i Kosovës përbëhet nga: Gjykata Supreme, Gjykata e Lartë për Kundërvajtje, pesë Gjykata të Qarkut, Gjykata Ekonomike, 26 Gjykata Komunale, 25 Gjykata Komunale për Kundërvajtje. Këshilli gjyqësor i Kosovës përbëhet nga 13 anëtarë të cilët sigurojnë që gjykatat në Kosovë të jenë të pavarura, profesionale dhe të paanshme.²⁸ Kryetari i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, z.Enver Peci gjatë një konferencë për media tha se zvogëlimi i lëndëve të grumbulluara do të bëhet në rast të rritjes së numrit të gjyqtarëve poashtu edhe me zbatimin e Ligjit të ri për Gjykatat, i cili ligj parasheh që gjyqësori i Kosovës do të përballet me ristrukturimin e plotë të sistemit gjyqësor, të gjitha gjykatat në Kosovë do

²⁷Komisioni Evropian; Raporti i Progresit 2011 për Kosovën; Tetor 2011; http://mei-ks.net/repository/docs/Raporti_i_Progresit_per_Kosoven_2011_-_Shqip.pdf

²⁸ Kushtetuta e Republikës së Kosovës: Neni 108, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, 15 qershor, 2008, fq. 42

t'i nënshtrohen transformimit të rrënjësishëm në bazë të strukturës dhe juridiksionit.

Këshilli Gjyqësor ende nuk ka arritur përbërjen e tij të plotë. Kuvendi pritet të emërojë tre anëtarë të Këshillit, duke përfshirë dy gjyqtarë nga komunitetet pakicë.²⁹



Nga statistikat e këtij institucioni shohim se përgjatë vitit 2011 janë ndërmarrë një sërë vendimesh dhe masash në luftë kundër korrupsionit. Statistikat e ndara sipas Gjykatave për veprat penale kundër detyrës zyrtare³⁰: Gjykata e Qarkut, gjatë periudhës raportuese i ka trashëguar 45 lëndë, 24 lëndë të pranuar, 16 lëndë të zgjidhura. Nga 9 lëndë më aktgjykim gjykues, 6 lëndë kanë përfunduar me burg, 3 me dënim me kusht, 1 lëndë dënime tjera, 2 lëndë me aktgjykim

²⁹ Komisioni Evropian; Raporti I Progresit 2011 për Kosovën; Tetor 2011

³⁰ Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës sanksionon 13 lloje të veprave korruptive: shpërdorim të detyrës zyrtare ose autorizimit, përvetësim gjatë ushtrimit të detyrës, mashtrim në detyrë, përdorim i paautorizuar i pasurisë, marrja e ryshfetit, dhënia e ryshfetit, ushtrim i ndikimit, nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore, zbulim i fshehtësive zyrtare, falsifikim i dokumenteve zyrtare, arkëtim dhe pagesa e paligjshme, lirim i kundërligjshëm i personit të privuar nga liria, përvetësim i kundërligjshëm i pasurisë me rastin e bastisjes apo ekzekutimit të vendimit gjyqësor

lirues, dhe 5 lëndë në mënyra tjera. Në fund të periudhës raportuese kanë mbetur 53 lëndë të pazgjidhura.

Nëse e krahasojmë numrin e lëndëve të pranuar gjatë kësaj periudhe me numrin e lëndëve që janë zgjidhur, del se Gjykatat e Qarkut kanë qenë efektive në masën 66.6%. Gjykatat Komunale kanë

trashëguar 206 lëndë, 132 janë pranuar gjatë kësaj periudhe, ndërkaq 120 lëndë janë të zgjidhura. Nga 82 lëndë me aktgjykim gjykues, 14 lëndë kanë përfunduar me dënim me burg, 45 lëndë me dënim me gjobë, 22 dënim me kusht, 1


lëndë dënime të tjera. Me aktgjykim lirues janë shqiptuar 6 lëndë, me aktgjykim refuzues 3, 29 lëndë në mënyra të tjera. Në fund të këtij viti kanë mbetur 218 lëndë të pazgjidhura.

Nëse e krahasojmë numrin e lëndëve të pranuar në fillim të vitit me numrin e lëndëve që janë zgjidhur gjatë fundit të periudhës raportuese del se gjykatat komunale kanë qenë efektive 91.6 %.

Prokuroria e Kosovës

Ligji mbi Këshillin Prokurorial të Kosovës ka hyrë në fuqi më 1 janar 2011. Të nëntë anëtarët e Këshillit Prokurorial janë emëruar, derisa Këshilli ka filluar punën. Ai ka marrë disa përgjegjësi nga Ministria e Drejtësisë dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës, dhe ka funksionalizuar dy trupa kryesorë tanimë: komisionin disiplinor si dhe kolegjin për rekrutimin e prokurorëve të rinj. Këshilli

ka caktuar prokurorë specialë për t'u marrë me krimin e organizuar, krimin ekonomik, korrupsionin dhe trafikimin e genieve njerëzore në gjitha gjykatat e qarkut dhe ato komunale.³¹



Prokuroritë e Republikës së Kosovës gjatë vitit 2011 kanë paraqitur 959 kallëzime penale kundër 1862 personave, lëndë të cilat kanë të bëjnë me korrupsionin. Gjatë periudhës janar-dhjetor 2011 prokuroritë e vendit kanë zgjidhur 538 kallëzime penale kundër 1038 personave, ndërkaq kanë mbetur të pazgjidhura 421 kallëzime penale kundër 824 personave. Nga rastet e zgjidhura, janë ngritur 107 propozim akuza kundër 139 personave, janë ngritur 107 aktakuza kundër 478 personave, janë hedhur 165 kallëzime penale kundër 216 personave dhe janë pushuar 31 hetime kundër 71 personave.


Policia e Kosovës

Në Kosovë, ekziston një mungesë e përgjithshme e komunikimit mes Policisë së Kosovës, zyrave të prokurorive komunale dhe të qarkut dhe gjykatave. Hetuesit e policisë, dhe në veçanti prokurorët dhe gjykatësit përballen me një barrë të papërbalueshme të punës kundruall kapaciteteve të tyre³². Megjithatë, Policia e Kosovës ka vazhduar të perceptohet nga qytetarët e Kosovës si institucioni më i besueshëm dhe më pak i korruptuar. Sipas statistikave të Drejtorisë për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsion (DHKEK) rezulton që gjatë viti 2011 janë kryer hetime ndaj 739 personave dhe 97 prej tyre janë arrestuar. 319 janë dërguar në Prokurori me kryerës të njohur, 11 raste janë dërguar në prokurori me N/N dhe

³¹ Komisioni Evropian; Raporti i Progresit 2011 për Kosovën; tetor 2011

³² KIPRED; Trekëndëshi i brishtë; shkurt 2010

192 raste të dërguara me raport të Prokurorit.



Ndërkaq, dëmi i supozuar nga veprat e tilla penale kundër detyrës zyrtare përlloritet të jetë rreth 11.237.667,00 euro.

Agjencia Kundër Korrupsionit

Agjencia Kundër Korrupsion (AKK), gjatë vitit 2011 ka raportuar për rritje të korrupsionit duke u bazuar në informatat që i ka pranuar si dhe ato që i ka dërguar në prokuroritë vendore³³. Më shumë se 95 për qind e zyrtarëve të lartë publik e kanë deklaruar pasurinë e tyre tek Agjencia kundër Korrupsionit, brenda afatit kohorë, të cilin e përcakton Ligji për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave.³⁴ Po sipas këtij raporti numri i atyre që nuk e kanë deklaruar pasurinë është 84 zyrtarë apo 4.60%, ndërsa 26 zyrtarë të tjerë e kanë deklaruar pasurinë e tyre por në fakt formulari nuk është plotësuar konform ligjit dhe standardeve dhe kritereve të cilat i ka përcaktuar AKK-ja

³³ Krahasim me thelbësor i këtyre të dhënave bëhet vetëm duke i ballafaquar të dhënat e vitit 2010 me ato 2011, raporti i 2011 i AKK del gjate muajit mars te 2011.

³⁴ Agjencia Kundër Korrupsion; www.akk-ks.org

Ky institucion ka ndërmarrë nismën për përpilimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit Kundër Korrupsionit (2012-

2016), dokumente shtetërore për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit. Strategjia dhe Plani i Veprimit tashmë janë hartuar nga AKK-ja, përderisa pritet miratimi i saj nga Qeveria dhe Kuvendi. Efektet konkrete të këtyre

dokumenteve priten të shihem vetëm pas viteve në vijim.

Strategjia dhe Plani i Veprimit 2009-2011, nuk kanë dhënë ndonjë efekt konkret në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit. Kjo, pjesërisht -pasi që procesi i përpilimit të këtyre dokumenteve strategjike kundër korrupsionit është përcjellë me të meta substanciale dhe kështu me përmbajtje të dobët³⁵. Por, kjo po ashtu edhe për shkak të mungesës së vendosmërisë së lidërshiptit politik për tu ballafaquar me korrupsionin.

Gjatë viti 2011, janë aprovuar dy ligje të pakos kundër korrupsion; Ligji për deklarimin e Pasurisë dhe ai për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, të cilët në dukje i kanë mundësuar AKK-së luftë më të suksesshme kundër korrupsionit. AKK-ja, gjatë viti 2011, ka bërë edhe një analizë mbi ndjekjen dhe gjykimin e rasteve korruptive në

³⁵ Levizja FOL; Strategjia Kundër Korrupsion: Hulumtim Politikash: Dobësitë e Strategjisë Kundër Korrupsion dhe Plan

Kosovë.³⁶ Kjo analizë tregon për një ngecje të lartë të mekanizmave institucional në ndjekjen dhe gjykimin e rasteve korruptive.

Doganat e Kosovës

Statistikat e Doganave të Kosovës, tregojnë se përgjatë vitit 2011, janë shqiptuar 41 masa disiplinore, 25 vërejtje me shkrim/gojë, 9 raste ndalim promovimi, 1 rekomandim për mosvazhdim të kontratës së punës, 2 raste rekomandimi për trajnim, 3 raste transferimi i detyrueshëm, 1 rast degradim nga pozita, 1 rast anulim performance dhe 1 rast kompensim i pronës së dëmtuar të Doganave. Ndërkaq, në kuadër të Sektorit për Standarde Profesionale, Doganat e Kosovës kanë iniciuar gjithsejt 21 raste: 3 për keqpërdorim të detyrës zyrtare, 2 raste për neglizhencë gjatë kryerjes së detyrës zyrtare, 7 raste për sjellje joprofesionale, 2 raste për mosdeklarim, 4 raste për dëmtim të pronës së Doganës, 1 rast për mosparaqitje në punë, 1 për marrje ryshfeti dhe 1 rast për marrje të narkotikëve.

Më 8 qershor 2011 Prokuroria Speciale e Kosovës pati ngritur aktakuzë ndaj Naim Hurglicës (drejtor i Doganave të Kosovës) dhe Lulzim Rafunës (zyrtar ligjor në Doganat e Kosovës). Aktakuza ndërlidhej me dyshimet për shpërdorim të detyrës zyrtare. Gjatë muajit shtator në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë u mbajt seanca për konfirmimin e kësaj aktakuze. Të pandehurit akuzoheshin se kanë shpërdoruar detyrën zyrtare ose autorizimin dhe kanë keqpërdorur

autorizimin në ekonomi, vepra këto që sanksionohen me nenet 236 paragrafi 1 dhe 339 të KPK-së. Sipas aktakuzës të pandehurit në vitin 2008 i kanë mundësuar dhe lejuar kompanive: “Gekos”, “Buqaj”, “Tabako” dhe “Kosova Tobacco”, që të importojnë një sasi të madhe të duhanit, pas vendimit të Qeverisë së Kosovës për ngritjen e akcizës së importit të duhanit nga janari i vitit 2009. Me këtë vendim ishte ndaluar importi i sasive të mëdha të duhanit. Të pandehurit me veprimet e tyre ju kishin mundësuar këtyre kompanive që të importojnë sasi të mëdha të duhanit, ndaj i kanë shkaktuar dëm buxhetit të Kosovës në vlerë prej 500.000 euro. Gjykatësi paraprak jashtë seancës në afat ligjor mori aktvendim me të cilin hodhi poshtë aktakuzën e prokurorisë Speciale të Kosovës kundër dy të pandehurve dhe atë sipas nenit 316 paragrafi 1, 2 dhe 4 të KPPK-së. E arsyetimi i gjykatës ishte se në këtë rast nuk ka vepër penale dhe se veprimet e përshkruara në aktakuzë nuk kalojnë përtej dyshimit të bazuar. Kjo për faktin se të pandehurit nuk kanë përfituar asgjë materialisht për vete.³⁷

Raportet Ndërkombëtare

Viti 2011 është karakterizuar me vështirësi serioze që prej pavarësisë së vendit. Raportet ndërkombëtare e kanë pasqyruar Kosovën si vend të zhytur në korrupsion dhe krim të organizuar dhe me një përfshirje të nivelit të lartë politik vendor në këto aktivitete të pa-ligjshme. Vendi ka shënuar ngecje në pothuajse të gjitha raportet relevante ndërkombëtare që masin përparimin e sundimit të ligjit dhe konsolidimin e institucioneve

³⁶ Agjencia Kundër Korrupsion – “Analizë mbi ndjekjen dhe gjykimin e rasteve korruptive në Kosovë”, Korrik2011

³⁷Gazeta Jeta në Kosovë;
www.jetanekosove.com/lexo/830/Alb

demokratike. Si e tillë, Kosova nuk ka shënuar asnjë përparim në luftën e saj kundër kimit të organizuar dhe korrupsionit, por lufta ndaj këtyre aktiviteteve të paligjshme është kufizuar vetëm në aspektin deklarativ. Regresi i paraqitur në këto raporte ka bërë që Kosova të izohet si shtet në pjesëmarrjet e saj ndërkombëtare dhe lidhshipi i saj të jetë mbetet pa kredibilitet dhe me legjitimitet të cinguar.

Raporti i Progresit³⁸

Raporti i Progresit i Komisionit Evropian megjithëse evidenton një përparim të vogël në luftimin e korrupsionit, pranon se Kosova duhet të bëjë më shumë në këtë drejtim. Sipas Raportit ka një përparim të kufizuar cilësor në legjislacionin kundër korrupsionit. Po ashtu, raporti thekson se përparim i kufizuar është bërë edhe në ndjekjen penale të rasteve korruptive. Për më shumë, raporti kritikon edhe përparim të kufizuar në ndërtimin e strukturave për ta luftuar korrupsionin. Po ashtu, edhe në aspektin e ndjekjes penale të rasteve të korrupsionit, përveç nisjes së hetimeve, ngritjen e disa aktakuzave, në vitin 2011 nuk ka pas gjykim të ndonjë rasti të nivelit të lartë të korrupsionit.

Transparency International³⁹

Indeksi kryesor dhe i vetmi, i cili e matë perceptcionin e korrupsionit, tregon se gjatë vitit 2011, Kosova ka shënuar rënie duke u ranguar e 112-a. Ky rangim e vendosë Kosovën të fundit për nga

korrupsionit në krahasim me vendet e rajonit. Gjithashtu, sipas këtij Indeksi Kosova barazohet në këtë aspekt me vendet që kanë probleme të mëdha me shtrirjen e korrupsionit duke e klasifikuar vendin si “highly corrupt”.

Freedom House

Freedom House në raportin e titulluar “Nations in Transit”, thotë se progresi demokratik ka shënuar rënie nga viti 2010. Kosova në të gjitha kategoritë ose ka shënuar regres ose ka mbetur me vlerësim të njëjtë si në vitin 2010⁴⁰. Nëse shikohet ndër vite, që nga 2002, kur Freedom House ka filluar të masë progresin demokratik, Kosova përveç në vitin 2003, gjithmonë ka shënuar rënie. Me këtë rangim, Kosova klasifikohet nga FH si vend “gjysmë i lirë”.

Departamenti i Shtetit

Edhe raporti i Departamentit të Shtetit ka pasqyruar një sërë mangësish në përparimin e gjithëmbarshtëm demokratik dhe të forcimit të sundimit të ligjit në Kosovë. Raporti, në mes tjerash, përmend edhe problemet që Kosova ka me “korrupsionin qeveritar”. Po ashtu, Raporti identifikon stagnim në sferën e gjyqësorit dhe atë të të drejtave të njeriut.

Raporti i Pulsit Publik⁴¹

Kombet e Bashkuara, që prej instalimit të administratës së UNMIK-ut, kanë përpiluar hulumtime me synim të pasqyrimin të gjendjes së qytetarëve

³⁸ Komisioni Evropian, Raporti i Progresit për Kosovën; tetor 2011;

http://ec.europa.eu/enlargement/press_corner/key-documents/reports_oct_2011_en.htm

³⁹ Transparency International; nëntor 2011

<http://cpi.transparency.org/cpi2011/results>

⁴⁰ Ariana Qosaj-Mustafa për Freedom House ; Nations in Transit, 2011.

http://www.freedomhouse.org/sites/default/files/inline_images/NIT-2011-Kosovo-0.pdf

⁴¹ UNDP; Raporti i Pulsit Publik ; shtator 2011

<http://www.kosovo.undp.org/repository/docs/Public-Pulse-ëeb-sq.pdf>

karshi zhvillimeve politike, sociale dhe ekonomike në përgjithësi. Këto hulumtime kanë ofruar të dhëna empirike, të cilat tregojnë që besueshmëria e qytetarëve të vendit me institucionet publike ka shënuar rënie të vazhdueshme. Madje, në të gjithë indikatorët, që prej 2005, të dhënat tregojnë rënie të vazhdueshme të kënaqësisë së qytetarëve. Këtu korrupsioni përmendet si njëri prej shqetësimeve më të mëdha të qytetarëve ku në rastin e punësimit në institucione publike, nepotizmi duket të jetë imperativi kryesorë për punësim. Në këtë hulumtim tregohet që 33% e qytetarëve mendojnë që për t'u punësuar në administratë publike apo në kompani publike duhet të kesh lidhje familjare, 19% e tyre mendojnë se ryshfeti u ndihmon për punësim, 10% mendojnë se afërsia partiake mundëson punësimin. Vetëm 15% e qytetarëve mendojnë që edukimi u ndihmon të punësohen, 8% prej tyre mendojnë që eksperiencia profesionale mundëson punësimin dhe vetëm 1% e qytetarëve mendojnë se edukimi profesional ua mundëson punësimin në institucione publike.

Raportet nga Shoqëria Civile

Edhe shoqëria civile në Kosovë, e cila pranohet gjerësisht se është esenciale për proceset demokratizuese në vendin tonë, ka ndërmarrë një sërë aktivitete në luftë kundër korrupsionit dhe praktikave tjera korruptive. Qëllimi i aktiviteteve të shoqërisë civile, ka qenë denoncimi i praktikave korruptive dhe deformuese të keqqeverisjes.

Organizata “Çohu”

Organizata për Demokraci, Anti-korrupsion dhe Dinjitet, ÇOHU!, përgjatë viti 2011, ka përpiluar një analizë⁴² mbi kornizën ligjore antikorrupsion.

ÇOHU! ka evidentuar në këtë analizë se korniza ligjore kundër-korrupsion vazhdon të mbetet e mangët dhe me defekte serioze në përmbajtje. Sipas kësaj organizate, korniza ligjore dhe institucionale kundër-korrupsion, qysh kur ka filluar të ndërtohet më 2004 nuk ka shënuar ndonjë përparim kualitativ. Prandaj, sipas ÇOHU! përpjekjet për ngritjen e një kornize efektive dhe adekuate institucionale dhe ligjore kundër-korrupsion nuk kanë krijuar ndonjë ndikim thelbësorë në luftën kundër korrupsionit.

Po ashtu, kjo organizatë ka publikuar edhe një raport hulumtues⁴³ mbi parashkrimin e lëndëve penale. Ky raport pasqyron gjendjen e rëndë sa i përket parashkrimit të lëndëve penale. Raporti tregon se në total, nga viti 2001 deri më 2011, afër 7000 mijë lëndë penale janë parashkruar si në aspektin absolut po ashtu edhe në atë relativ.

Instituti Demokratik i Kosovës

Instituti Demokratik i Kosovës përgjatë viti 2011, në mes tjerash, ka qenë i fokusuar kryesisht në fushë e financimit të partive politike. Ky Institut ka bërë publikimin e një sërë raporteve⁴⁴ në këtë fushë, ku ka evidencuar mangësi në legjislacionin për financimin e partive

⁴²Organizata Çohu, Analizë Politikash: Korniza Ligjore Kundër Korrupsionit, “Mangësitë dhe Nevoja e Rishikimit”, Dhjetor 2011.

⁴³Organizata Çohu, Raport Monitorues: “Parashkrimi i Ndjekjeve Penale dhe Ekzekutimeve Penale” Janar 2012

⁴⁴ Instituti Demokratik i Kosovës; ëëë.kdi-kosova.org

politike, shkelje të ligjit për financimin e partive politike si dhe mos transparencë në financimin e partive politike.

Po ashtu, KDI-ja ka bërë publikimin edhe të një raporti mbi legjislacionin dhe praktikën e vendeve të rajonit në luftimin e krimit të organizuar dhe pastrimit të parave. Këtu KDI-ja ka ofruar një analizë krahasuese të ligjeve dhe të praktikave të vendeve të rajonit në luftimin e krimit të organizuar dhe pastrimit të parave.

Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillim të Politikave - KIPRED

Instituti KIPRED, gjatë viti 2011 ka qenë i fokusuar në disa drejtime ku në mes tjerash ka bërë edhe analizimin e legjislacionit për konfiskimin e pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme⁴⁵. Këtu, KIPRED-i ka shtjelluar mangësitë dhe konfuzionin në legjislacionin për konfiskimin e pasurisë. Sipas këtij Instituti në legjislacionin e tanishëm ka bazë për konfiskimin e pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme.

⁴⁵ KIPRED – Konfiskimi i Pasurisë së Fituar në Mënyrë të Kundërligjshme, Prill 2011.

Falënderime

Publikimi i këtij Raporti u mundësua nga Ambasada Britaneze në Prishtinë.

Ky Raport është produkt dhe rezultat i kontributit të një ekipi të përkushtuar, si nga stafi i lëvizjes FOL, por edhe nga bashkëpunëtorët e jashtëm. Në këtë kontekst, Lëvizja FOL falënderon publikisht të gjithë personat që punuan në sigurimin e informacioneve dhe përpilimin e këtij raporti. Të gjitha Raportet e Lëvizjes FOL mbi Aktivitetet e Institucioneve Publike të Kosovës në Luftë kundër Korrupsionit janë të publikuara në këtë ëbfaqe: www.lëvizjafol.org

Rreth Lëvizjes FOL

Lëvizja FOL angazhohet për të fuqizuar ndikimin qytetar në vendimmarrje, për qeverisje të përgjegjshme dhe efikase. FOL është thellësisht e përkushtuar që të punojë në përmirësimin dhe arritjen e niveleve më të mira të përfaqësimit qytetar në jetën publike. FOL punon për qeverisje të mirë dhe të bazuar në parimet demokratike, për institucione të përgjegjshme, transparente dhe llogaridhënëse, si dhe për zbatim dhe hartim të ligjit me pjesëmarrje. Prandaj, shpenzimi i fondeve publike, konfliktit të interesit, neglizhenca dhe përgjegjësia institucionale, si dhe qasja në informacione zyrtare, përbëjnë çështjet kryesore të punës së FOL. Në përmbushje të këtyre qëllimeve, FOL mëton të luftojë apatinë dhe indiferencën qytetare si dhe ta bëjë më aktiv dhe më të dëgjueshëm zërin e qytetarit; ta bëjë atë pjesë aktive të interesit të komunitetit dhe përherë të gatshëm që t'i kundërvihet abuzimit,

keqpërdorimit, korrupsionit dhe formave tjera deformuese të qeverisjes.

Kontakt:

Andrea Gropa 29, 100000 Prishtinë,
Republika e Kosovës
Mob: +377 (0) 44 131 542
Ueb: levizjafol.org
E-mail: info@levizjafol.org